



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
Sektori Pronësoro-Juridik

<i>Me datë</i>	22.05.2025
<i>Referenca</i>	1Nr.353/01-25491
<i>Për</i>	Drejtoratit për Administratë-Sektorit për punë të Kuvendit dhe Komiteteve
<i>Nga</i>	Gafurr Hetemi, UD- i Udhëheqësit të Sektorit Pronësoro-Juridik
<i>Lënda</i>	Dërgimi i propozim-Vendimit ref.1Nr.353/01-25491 datë 22.05.2025 dhe akteve në orgjinal për miratim në Kuvendin e Komunës



Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 13 paragrafi 13.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, ju dërgojmë propozim-Vendimin ref. 1Nr.353/01-25491 datë 22.05.2025 të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacioni për ndërtimin e shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në ZK-Krojmir, për miratim në Kuvendin e Komunës.

Aktin e lartëcekur i'u dërgojmë edhe në formë elektronike –emailit zyrtar.

Aktet i'u dërgohen të përshkruar si në vijim;

- Vendim 1Nr.353/01-25491 datë 22.05.2025 caktimin e lokacioni për ndërtimin e shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në ZK-Krojmir,
- Certifikatë Ref. 2537 /2025 datë 21.05.2025 e njesisë kadastrale P-71409039-01232-2 në ZK-Krojmir, dhe
- Kopja e Planit datë 21.05.2025 në ZK-Grackë e Vjetër.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 (shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe nenit 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, informacioni urban nga DPUMM datë 16.05.2025 Ref 8-351/01-24201, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____2025, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E SHTËPISË MUZE TË VETERANËVE TË UÇK-së NË ZONËN KADASTRALE KROJMI

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për ndërtimin e shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në ZK-Krojmir, kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në ZK-Krojmir, kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së.-së, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale P-71409039-01232-2 me sipërfaqe prej 2200m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 12201m² Zona Kadastrale në Krojmir në pronësi të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për lejimin e ndërtimit të shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së, në lokacionin e përshkruar si në nenin 2 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Infrastruktur, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, informacioni urban nga DPUMM datë 08.05.2023

Përmes shkresës 01-463/02-24982 të datës 20.05.2025, Drejtoratit për Infrastruktur pas kërkesës së banorëve të fshatit Krojmir, për ndarjen e një pjese të pronës komunale me sipërfaqe prej 2200m² nga parcela kadastrale P-71409039-01232-2 në ZK-Krojmir, me qëllim të ndërtimit e shtëpisë muze të veteranëve të UÇK-së në ZK-Krojmir, kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së.

Në bashkëpunim me zyrtarët e Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër-Sektori i Gjeodezisë, do të beher parcializimi i lokacioni të sipërfaqes sipas nenit 2 të këtij propozim-Vendimi, konkretisht në parcelën kadastrale P-71409039-01232-2 në zonën kadastrale në Krojmir me sipërfaqe prej 12201m² në ZK-Krojmir në pronësi të Komunës së Lipjanit.

Nga të cekurat më lartë, me qëllim të nderimit dhe mirënjohës, kushtuar luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

INr. 353/01-25491
Datë 22.05.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409039-01232-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 2537/2025
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 21.05.2025 - 13:38
Komuna / Opština / Municipality: LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Krojmir / Krajimirovce / Krojmir
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409039-01232-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		12201			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
TRNAVA LJUGI MAL				



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Krojmir

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71409039-01232-2	Parcelë / Parcela / Parcel	12201



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1310

Punoi/Obradio/Created: Ilir Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 21.05.2025

Koha/ Vreme/ Time: 01:36:42